



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

Kryesues i Senatit  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 27032 Dt 07.11.2022

Në bazë të nenit 49, paragrafi 1, nënparagrafi 9, si dhe nenit 203 dhe 208 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2022, mori:

**VENDIM**

1. Aprovohet draft-Rregullorja e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë.
2. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Menaxhmentit.
3. Fakulteteve
4. Zyrës për komunikim me publikun

Prof. dr. Alush Musaj  
Kryesues i Senatit të UIBM





**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

Nr. Prot. 2792 Dt. 07.11.2022

Në mbështetje të nenit 203 dhe 208 të Statutit të Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2022, miratoi:

**RREGULLOREN  
E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT NË UNIVERSITETIN "ISA  
BOLETINI", NË MITROVICË**

**Neni 1**

**Fushëveprimi**

- I. Universiteti “Isa Boletini”, në Mitrovicë (UIBM), ka vendosur një kornizë të sigurimit të cilësisë, e cila zbatohet në përputhje me parimet e Zonës Evropiane të Sigurimit të Cilësisë;
- II. Kjo rregullore përcakton procedurat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, fushëveprimin e vlerësimit të brendshëm, mekanizmat dhe instrumentet e vlerësimit, si dhe organet përgjegjëse për sigurim të cilësisë.

**Neni 2**

**Qëllimi**

- I. Përcaktimi i mekanizmave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit në Universitetin “Isa Boletini”, në Mitrovicë;
- II. Definimi i rolit dhe përgjegjësisë së njësive organizative dhe akademike në Universitet, për realizimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit;
- III. Definimi i mekanizmave dhe proceseve që përafrojnë Universitetin me standartet e ENQA-s për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit;
- IV. Fuqizimi i sistemit të sigurimit të cilësisë që përfshin përmirësimin e praktikave për të gjithë akterët e përfshirë, duke e zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme kulturën e cilësisë në kuadër të UIBM;

**Neni 3**

**Parimet dhe vlerat, mbi të cilat bazohet cilësia në UIBM**

- I. Sigurimi i cilësisë në UIBM bazohet në parimet dhe vlerat si:
  - a) Përgjegjësia;
  - b) Transparency;
  - c) Llogaridhënia;
  - d) Integriteti akademik;
  - e) Përmirësimi i vazhdueshëm;
  - f) Gjithëpërfshirja.



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY “ISA BOLETINI” MITROVICË

### Neni 4

#### **Rolet dhe përgjegjësitet**

- I. Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UIBM parashev përfshirjen e gjithë akterëve në marrjen e përgjegjësive për procedurat dhe rezultatet e sistemit të sigurimit të cilësisë, si në vijim:

**Këshilli Drejtues** është përgjegjës për integrimin e rezultateve të sigurimit të cilësisë në politik-bërjen dhe planifikimin strategjik të institucionit.

**Senati** është përgjegjës tëaprovojë rregullativën e brendshme të sigurimit të cilësisë, si dhe të sigurojë se çdo program i studimit është subjekt i vlerësimit të rregullt të cilësisë para aprovimit.

**Rektori** është përgjegjës të sigurojë burime të mjaftueshme për funksionimin efektiv të procedurave të sigurimit të cilësisë. Rektori siguron se, funksionet e sigurimit të cilësisë janë plotësisht të integruara në menaxhimin ditor dhe të rregullt të institucionit.

**Prorektoret** me detyrat dhe përgjegjësitet e caktuara në bazë të Statutit të UIBM-së, përkatësisht nen 35.

**Dekanët** janë përgjegjës për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në nivelin operacional dhe të çdo faze të zbatimit të planprogramit të studimit.

**Prodekanët për cilësi dhe bashkëpunim ndërkombëtar** merren me promovimin e praktikave më të mira të cilësisë dhe sigurimin e zbatimit të tyre në nivel të njësisë akademike.

**Koordinatori për sigurim të cilësisë** ndihmon në organizimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe jashtëm, përfshirë koordinimin e raporteve të vet-vlerësimit, organizimin e vizitave të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët ndërkombëtarë, analizimin dhe krasimin e raporteve të jashtme të vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtarë, etj.

**Staf akademik** siguron se politikat e sigurimit të cilësisë reflektohen në çdo aktivitet të tyre, në raport me studentët dhe punën e tyre të pavarrur shkencore.

**Staf administrativ** mbështet çdo pjesëtar të komunitetit akademik për të arritur objektivat institucionale dhe për të shpërndarë gjërisht kulturën e cilësisë.

**Komisioni Qendror për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim** harton dhe zhvillon politikat dhe procedurat e cilësisë, në nivel të institucionit, si dhe promovon krijimin e një kulture të cilësisë.

**Zyra e Sigurimit të Cilësisë** zbaton orientimet strategjike, politikat, dhe procedurat e cilësisë në çdo nivel dhe në çdo fushë të veprimit të institucionit.

### Neni 5

#### **Mekanizmat për menaxhimin e sigurimit të cilësisë**

- I. Në UIBM, mekanizmat kryesorë që menaxhojnë me procesin e sigurimit të cilësisë janë:
- Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (KQSCV);
  - Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC);
  - Prodekanët për cilësi/Koordinatorët për cilësi në njësitë akademike

### Neni 6

#### **Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (KQSCV)**

- I. KQSCV-ja është organi kryesor në UIBM, i cili merret me procesin e sigurimit të cilësisë. Ky komision është organ këshilldhënës i Senatit të UIBM, për çështjet që kanë të bëjnë me



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

cilësinë. Anëtarët e KQSCV-së miratohen në Senatin e UIBM, për një mandat 4 vjeçar. Pas përfundimit të këtij mandati, së paku 1/3 e anëtarëve të KQSCV-së parashihet të jenë pjesë e tij, me qëllim të sigurimit të vazhdimesisë në punën e Komisionit.

- II. KQSCV-ja në përbërjen e tij siguron një gjithpërfshirje me sa vijon:
  - a) Prorektori për cilësi (ex-officio);
  - b) Zyrtari nga zyra për sigurimin e cilësisë (ex-officio);
  - c) Deri në 6 përfaqësues të personelit akademik nga njësitat e ndryshme akademike;
  - d) 2 përfaqësues të studentëve.
- III. KQSCV-ja ka për detyrë që:
  - a) të rishikojë Rregulloren për sigurim të cilësisë dhe vlerësim;
  - b) të rishikojë Udhëzuesin e sigurimit të cilësisë;
  - c) të rishikojë paketën e instrumenteve për vlerësim, sipas propozimeve të njësive akademike;
  - d) të rishikojë dokumentin e treguesve të performancës;
  - e) të shqyrtojë raportet e paketës së instrumenteve për vlerësim;
  - f) të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit për akreditim institucional dhe të programeve;
  - g) të shqyrtojë planet e përmirësimit për riakreditim institucional dhe të programeve, në lidhje me nivelin e adresimit të çështjeve të ngritura nga AKA;
  - h) harton dhe rishqyrton Rregulloren për procedurat e përgatitjes për ri/akreditim institucional dhe të programeve studimore në UIBM.
- IV. Komisioni Qendror për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit, për punën e tij i raporton Senatit.

**Neni 7**

**Zyra për sigurimin e cilësisë**

- I. Zyra për sigurimin e cilësisë e UIBM-së (ZSC) është zyrë e pavarur, e cila drejtëpërdrejtë i raporton vetëm rektorit të UIBM-së. Kjo zyrë angazhohet në ngritjen e cilësisë në UIBM, duke zbatuar të gjithë politkën institucionale. Zyra përbëhet nga zyrtarët për cilësi, të rekrutuar përmes konkursit publik. Zyrtarët e cilësisë në ZSC nuk janë pjesë e stafit akademik të UIBM. Zyra kujdeset për matjen e cilësisë, përmes të gjitha instrumenteve të paketës së instrumenteve në UIBM. Zyra harton raporte me gjetje dhe rekondime për çdo pyetësor të zhvilluar, dhe atë e dërgon tek rektori i UIBM. Po ashtu, Zyra, të dhënat nga pyetësorët i dërgon tek dekani i njësisë akademike, me qëllim të planifikimit për zhvillim të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.
- II. Zyra ka për mision që të sigurojë nivel cilësor të mësimdhënies, mësimnxënies, programeve studimore, hulumtimit dhe administrimit të UIBM-së, përmes implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe të sigurojë që mekanizmat dhe procedurat përritjen e cilësisë të jenë funksionale. Përbushja e këtij misionit është në harmoni me misionin e institucionit dhe i shërbën përbushjes së vizionit të tij për të qenë Universiteti më i mirë publik në vend dhe rajon dhe për të përgatitur kuadro, të cilat do t'i kontribuojnë zhvillimit të komunitetit lokal dhe global, në fusha specifike të studimit.
- III. Roli dhe detyrat e ZSC-së janë:



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

- 
- a) Të sigurojë mbështetje dhe udhëheqje profesionale, administrative, udhëzime dhe mbështetje për sigurimin e cilësisë, në të gjitha nivelet e institucionit, dhe të ndihmojë organizimin e akreditimit institucional dhe të programeve studimore.
  - b) Të formulojë strategjitet, politikat, mekanizmat, procedurat dhe praktikat e ndryshme për sigurim dhe avancim të cilësisë akademike në institucion.
  - c) Të promovojë kulturën e cilësisë brenda institucionit.
  - d) Të këshillojë në aprovin dhe zhvillimin e moduleve dhe programeve studimore.
  - e) Të hartojë strategji dhe të ndihmojë në avancimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
  - f) Të koordinojë agjendën e aktiviteteve me koordinatorët e cilësisë, në nivel të fushave studimore.
  - g) Të përgatisë të gjitha dokumentet, në lidhje me akreditim apo riakreditim, raportet e ndryshme të vlerësimit të brendshëm, në bashkëpunim me të gjitha fakultetet, dhe të koordinojë vizitat e ekspertëve të huaj për akreditim apo riakreditim.
- IV. Zyra për sigurimin e cilësisë ka zyrtarin e lartë për cilësi, i cili është edhe udhëheqës i zyrës, dhe zyrtarë të tjerë. Detyrat e zyrtarit të lartë të ZSC-së janë:
- a) Ofron mbështetje administrative dhe profesionale për procedurat dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë në UIBM;
  - b) Shpërndan pyetësorë për stafin akademik, administrativ dhe për studentë, i analizon të dhënat e mbledhura, përmes mekanizmave për sigurimin e cilësisë, dhe, bazuar në analizën e pyetësorëve, përpilon raporte për shërbimet akademike dhe administrative që i ofron UIBM;
  - c) Ofron mbështetje administrative dhe profesionale për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve në Universitet, si dhe ofron mbështetje teknike për Komisionin Qendror për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit;
  - d) Kontrollon aplikacionet e Universitetit, sipas listës kontrolluese të Universitetit, të Agjencisë për Akreditim dhe të akteve ligjore përkatëse;
  - e) Përcjell progresin e aplikacioneve të Universitetit, që nga përgatitja për aplikim e deri te zbatimi i rekomandimeve, dhe i mirëmban dhe i shqyrton dosjet e procesit të akreditimit, si dhe përgatit raporte dhe analiza përkatëse;
  - f) Drafton, së bashku me zyrtarët e tjerë të zyrës, dokumentin e RVV-së për UIBM-në;
  - g) Ofron këshilla, udhëzime dhe shërbime të përshtatshme për stafin akademik në zhvillimin e projekteve hulumtuese (p.sh. informimi për fondet e donatorëve, çështjet ligjore, bashkëpunimet e mundshme me komunitetin e biznesit, etj.);
  - h) Shërben si person kontaktues në UIBM për projektet e karakterit hulumtues shkencor, si ERASMUS+, Horizon 2020,
  - i) kryen punë të tjera, të cilat ia cakton nëpunësi mbikëqyrës.



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY “ISA BOLETINI” MITROVICË

### Neni 8

#### **Prodekani për sigurim të cilësisë dhe bashkëpunim ndërkombëtar**

- I. Prodekani për cilësi i njësisë akademike propozohet në Këshill të Fakultetit nga dekanii i njësisë dhe votohet nga Këshilli i njësisë akademike. Ai merret me promovimin e praktikave më të mira të cilësisë dhe sigurimin e zbatimit të tyre në nivel të njësisë akademike. Ndhimon në organizimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë koordinimin e raporteve të vetëvlerësimit, organizimin e vizitave të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët ndërkombëtarë, analizimin dhe krashtimin e raporteve të jashtme të vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtarë, etj. Harton dhe koordinon procese që sigurojnë informimin e saktë të akterëve relevant, në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm, akreditimit dhe statusin e programeve të akredituara brenda njësisë akademike.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tij janë:
- Punon, duke u këshilluar ngushtë me dekanin, ZSC-në, prorektorin për çështje të cilësisë dhe prorektorin për bashkëpunim ndërkombëtar;
  - Vepron si përkrahës për sigurimin e cilësisë brenda Fakultetit;
  - Zhvillon, drejton, planifikon dhe ofron strategjinë, si dhe proceset për cilësi dhe zgjerim të bashkëpunimit ndërkombëtar;
  - Oftron shërbime dhe ndihmesë për zbatimin e praktikave dhe nismave më të mira;
  - Këshillon në aprovin e zhvillimin e moduleve dhe programeve studimore;
  - Përkrah zbatimin për strategjitet e përmirësimit të cilësisë;
  - Ofron bashkëpunim për Grupin e Ekspertëve të jashtëm Vlerësues dhe për procesin e ri/akreditimit;
  - Ofron përkrahje për mbarëvajtjen e procesit të monitorimit dhe pas akreditimit, të përcaktuara nga AKA;
  - Përgjegjës për përkrahjen e ZSC-së, sipas nevojës gjatë proceseve të vlerësimit përmes pyetësorëve;
  - Përgatit feed-back -un e përbushjes së rekomandimeve për fakultetin përkatës, nga procesi i vlerësimit, të shkruar në formë të planit të përmirësimit dhe të njëjtin e diskuton dhe e rregullon, në bashkëpunim me dekanin dhe ZSC-në.

### Neni 9

#### **Koordinatori për sigurim të cilësisë në kuadër të njësisë akademike**

- I. Koordinatorin për cilësi të njësisë akademike e propozon dekanii i përgjigjet drejtëpërdrejt vetëm atij. Koordinatori për cilësi, në nivel të njësive akademike, ka këto detyra dhe përgjegjësi:
- Ofron udhëzime për stafin akademik dhe studentët, lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së;
  - Udhëzon departamentin përkatës dhe Komisionin e Studimeve të njësisë akademike, gjatë procesit të akreditimit/riakreditimit për të hartuar/rishikuar programet e studimit;
  - Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafi akademik, studentët, Alumnit, bizneset apo anëtarët e Bordit Këshillëdhënës) për hartimin/rishikimin e programeve të studimit;



## UNIVERSITETI - UNIVERSITY “ISA BOLETINI” MITROVICË

- 
- d) Mbështet, në procesin e vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, procesin e vetë-vlerësimit të stafit akademik, procesin e vlerësimit të stafit administrativ, takimet e këshillave të fakulteteve, takimet e rregullta të stafit akademik, me qëllim diskutimin për çështjet me interes në mësimdhënie, mësimnxenie apo kërkim;
  - e) Organizon sesione informuese për stafin akademik dhe studentët, lidhur me procesin e Bolonjës;
  - f) Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, sistemon të dhëna dhe informata, lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimi i punimeve shkencore, performanca artistike, projektet profesionale dhe shkencore);
  - g) Në bashkëpunim me zyrtarin për bashkëpunim ndërkombëtar, këshillon menaxhmentin dhe studentët e njësisë akademike, lidhur me realizimin e mobilitetit të studentëve - “Learning Agreement” (në përputhje me vendimin e njësisë akademike, shpjegon procedurat akademike të njoftes së kredive, marrëveshjen, transkriptin e shënimave, monitorimin para dhe pas realizimit të mobilitetit, etj.).

### Neni 10

#### Instrumentet e sigurimit të cilësisë

- I. Cilësia në UIBM përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, përmes rezultateve të vlerësimit, të cilat realizohen përmes instrumenteve për vlerësim me akterë të ndryshëm. Paketa e instrumenteve për vlerësime, në kuadër të UIBM, zakonisht, rishikohet sipas nevojës dhe publikohet në web-faqe të UIBM.
- II. Procesi i vlerësimit për sigurim të cilësisë në UIBM përfshinë akterët, si më poshtë:
  - a) Studentët;
  - b) Stafin akademik;
  - c) Stafin administrativ;
  - d) Menaxhmentin;
  - e) Të diplomuarit e UIBM; dhe,
  - f) Partnerët e jashtëm.

### Neni 11

#### Sigurimi i jashtëm i cilësisë

Vlerësimi i jashtëm në UIBM, ashtu si edhe për të gjitha IAL-të në Kosovë, është i harmonizuar me politikat e vendosura nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe politikat zhvillimore të shtetit. UIBM respekton të gjithë procedurën, rregullativën dhe normat e përcaktuara nga ana e AKA-së dhe KSHC-së. Po ashtu, UIBM ka rregulloren për procedurat e përgatitjes përi ri/akreditim institucional dhe të programeve studimore në UIBM, e cila e lehtëson procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë.

### Neni 12

#### Sistemi elektronik i menaxhimit të cilësisë

- I. Zyra e Sigurimit të Cilësisë administron procedurat e vlerësimit të cilësisë, përmes platformës elektronike të institucionit SEVC, në kuadër të SMU-së;

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokal 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
“ISA BOLETINI”  
MITROVICË**

- 
- II. Të dhënat e grumbulluara nga vlerësimet, si dhe raportet e vlerësimit, ruhen në bazën e të dhënave, e cila mundëson menaxhimin efikas të informacioneve.
  - III. Me qëllim të avancimit të menaxhimit të të dhënave të cilësisë, Zyra e Sigurimit të Cilësisë administron me platformën SEVC, në kuadër të SMU.

**Neni 13**

**Udhëzuesi për sigurim të cilësisë**

- I. Udhëzuesi për Sigurimin e Cilësisë është dokument i aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim;
- II. Udhëzuesi, në mënyrë të detajuar, përshkruan proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm;
- III. Udhëzuesi për Sigurimin e Cilësisë është dokument publik, i cili publikohet në web-faqen institucionale, si dhe në platformat e brendshme elektronike.

**Neni 14**

**Dispozitat kalimtare**

Në njësitë akademike, ku ende nuk ka të emëruar prodekan për Cilësi dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, në momentin e emërimit të prodekanit për Cilësi dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, pozita e koordinatorit për Cilësi, e përcaktuar sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje, pushon së e-izistuari.

**Neni 15**

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Prof. dr. Alush Musaj  
Kryesues i Senatit